



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 59, datë 09/12/2004

**“PËR SHQYRTIMIN E RASTEVE ME KONFLIKT  
NDËRMJET QYTETARËVE PËR APARTAMENTET QË NDODHEN NË  
RRUGËN “MYSLYM KETA”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore “Për shqyrtimin e rasteve me konflikt ndërmjet qytetarëve për apartamentet që ndodhen në rrugën “Myslym Keta”, mbështetur në ligjin Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32/e, në ligjin Nr.7652, dt.23/12/1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.49, dt.29/01/1993 “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.250, dt.16/04/1996 “Për procedurat dhe prioritetet”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.530, dt.17/10/1994 “Për mënyren e ndarjes së apartamenteve të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave”, ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.614, dt.05/12/1994,

**V E N D O S I;**

**I.** Të pajisen me autorizim definitiv qytetarët e mëposhtëm të pastrehë:

1. **Fadil Çela** – P.2, Sh.1, Ap.1 me strukture **2+1**
2. **Edmond Sadikllari** – P.2, Sh.1, Ap.2 me strukturë **2+1**
3. **Shaqir Alushani** – P.2, Sh.1, Ap.6 me strukturë **2+1**
4. **Luan Balili** – P.2, Sh.1, Ap.8 me strukturë **3+1**
5. **Arben Budo** – P.2, Sh.2, Ap.15 me strukturë **3+1**
6. **Haki Gole** – P.2, Sh.2, Ap.16 me strukturë **2+1**
7. **Tefik Ajazi** – P.4, Sh.3, Ap.18 me strukturë **3+1**
8. **Dritan Jazexhiu** – P.4, Sh.9, Ap.68 me strukturë **2+1**

**II.** Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore, Enti Kombëtar i Banesave.

**III.** Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**LUAN SHAHOLLARI**